

**LIGJI Nr. 04/L-168
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L -101 PËR FONDET
PENSIONALE TË KOSOVËS**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L -101 PËR FONDET
PENSIONALE TË KOSOVËS**

Neni 1

Neni 1 i ligjit bazik, pas përkufizimit “**1.44. Pension Plotësues Individual**”, shtohen dy përkufizime të reja 1.45., dhe 1.46., me tekstin si në vijim:

1.45. **Operacionet** – aktivitetet që financohen nga taksa operacionale dhe që lidhen me mbarëvajtjen e funksioneve operacionale të FKPK-së.

1.46. **Investimet** - aktivitetet që financohen nga taksa investive dhe që lidhen me aktivitetin e investimit të mjeteve pensionale.

Neni 2

1. Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 2., pika (k) riformulohet me tekstin si në vijim:

(k). Kuvendi i Kosovës cakton taksën investive dhe operacionale në bazë të kërkesës së Fondit për çdo vit kalendarik. Kërkesa duhet të jetë e specifikuar me të gjitha shpenzimet e përlllogaritura për periudhën për të cilën paraqitet kërkesa.

2. Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 2., pika (l) riformulohet me tekstin si në vijim:

(l). Kuvendi i Kosovës mund të caktoj taksë investive shtesë sipas kërkesës së Fondit për aktivitetet investive, varësisht nga aktiviteti financiar dhe lëvizjet e çmimeve në treg. Kërkesa duhet të jetë e specifikuar dhe arsyetuar, e cila pasqyron aktivitetin shtesë dhe çmimin e aktiviteve financiare për të cilat kërkohet taksa shtesë.

3. Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 2., pas pikës (l) shtohen dy pika të reja (m) dhe (n), me tekstin si në vijim:

(m). Fondi në raportin vjetor duhet të përfshijë edhe raportim të detalizuar për shpenzimet e taksës investive.

(n). Në rast se Kuvendi nuk mund të miratojë taksën investive dhe operacionale për vitin vijues, taksa e vitit paraprak, mbetet në fuqi deri në vendimin e ri të Kuvendit.

Neni 3

Neni 6 i ligjit bazik, paragrafi 12., pas tekstit “**dhjetë përqind (10%) të asaj shume neto**” shtohet teksti “**por jo më shumë se gjashtëqind (600) euro të kontributit të detyrueshëm për tremujor**”.

Neni 4 **Hyrja në Fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-168
12 mars 2013

Shpallur me dekretin Nr.DL-007-2013, datë 26.03.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga.